



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2017

Relacion mbi miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2018

Me shkresën Nr. 6441 Prot dt. 23 Nëntor 2017 (protokolluar në ERE me Nr. 758 Prot dt. 24 Nëntor 2017), OST sh.a, kërkon nga ERE të marrë në shqyrtim dhe të konsiderojë aplikimin në lidhje me rishikimin e tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018, sipas materialit që Shoqëria OST sh.a i ka bashkangjitur kësaj shkrese.

Bordi e ERE-s, me Vendimin Nr. 202 dt. 5 Dhjetor 2017 vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2018

Më tej ERE, me anë të shkresës 758/2 Prot, datë 7.12.2017, pas analizës së kryer këtij aplikimi I kërkoi informacion shtesë OST sh.a. në mënyrë që kompania të argumentonte më gjërë këtë aplikim dhe që ERE të ishte sa më e drejtë në llogaritjen e kostove që I përkasin OST sh.a në ushtimin e aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018.

OST sh.a. i u përgjigj kërkesave për informacion të ERE-s me anë të shkresës nr.7035, Prot., datë 15.12.2017. Pas analizës së përgjigjeve të OST sh.a u zhvillua një seancë teknike në datë 26.12.2017 me përfaqësuesin e kompanisë dhe më tej u ra dakord që të dergoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për paqartësitë në lidhje me analizën e kryer të aplikimit në vetvete dhe gjithashtu të përgjigjeve të dërguara nga OST sh.a. në kuadër të pyetjeve të dërguara nga ERE me anë të shkresave të lartpërmendura.

Në llogaritjen e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 OST sh.a ka llogaritur kostot totale që ajo do të përballojë gjatë gjithë vitit 2018 dhe respektivisht kostot e kapitalit, kostot operative të paraqitur në 4 skenare të ndryshme të mundshme, në varesi të supozimeve për pranimin e komponenteve të ndryshme që për rrjedhojë rezultojnë në nivele të ndryshme të tarifës mesatare të transmetimit për vitin 2018 duke e lënë në gjykimin e ERE-s pranimin e njerit ose tjetrit komponent apo skenar.

Aplikimi për tarifën e transmetimit përbëhet nga rreth 7 kapituj të cilët janë përgatitur në formë të përmbledhur në vijim:

Në kapitullin e parë, paraqitet një informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a ku listohen në mënyrë të detajuar përgjegjësitë kryesore të OST sh.a që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi, të tilla si menaxhimi i flukseve të energjisë, siguria e sistemit elektroenergjetik shqiptar, lidhja me sistemin e transmetimit, humbjet dhe shërbimet ndihmëse, shërbimet e balancimit, alokimin e kapaciteteve, transmetimin e të dhënave, sigurimin e informacionit si dhe bashkëpunimin dhe raportimin pranë ERE-s.

Në kapitullin e dytë të aplikimit flitet për nivelin e synuar të të ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit, e cila synon të shlyejë koston e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronesine, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e linjave, kablllove, nenstacioneve të transformatoreve, qendrave dispeçer dhe ndertesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-se që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.
- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-se, përfshirë pagesat e bera OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të castit dhe pagesat (nese ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive

Kapitulli i tretë i aplikimit flet për planifikimin e situatës energjitike për vitin 2018. Sipas këtij parashikimi, energjia që pritet të lëvrohet në rrjetin e OST sh.a për vitin 2017 është 7,814 GWh ndërsa ajo e planifikuar për vitin 2018 është 8,200 GWh.

Në bazë të të dhënave të paraqitura nga OST sh.a gradienti i rritjes së kërkesës për energji elektrike në shkallë vendi mbi baza vjetore është i rendit rreth 2%. Për vitin 2018 OST ka parashikuar rreth 5% më shumë energji të lëvruar në rrjetin e saj se sa viti 2017.

	Emertimi	Njesia e matjes	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Parashikimi vjetor 2017	Parashikimi për vitin 2018
I.	Energjia Totale që hyn në sistemin e OST sh.a.	GWh	7,830	8,463	7,814	8,200
a)	Prodhimi vendas	GWh	5,475	6,636	4,085	4,774
b)	Energji en marrje	GWh	2,355	1,827	3,729	3,426
II	Energjia totale e transmetuar	GWh	7,672	8,273	7,651	8,031
a)	Energjia elektrike e dhene	GWh	956	1,869	722	800
b)	Energjia elektrike për OSHEE	GWh	6,106	5,901	6,135	6,231
c)	Energjia elektrike për konsumatorët e kualifikuar	GWh	610	503	794	1,000
III	Humbjet në rrjetin e transmetimit t + NV					
a)	Humbjet në GWh	GWh	159	190	163	169
b)	Humbjet në %	%	2.03%	2.25%	2.09%	2.06%

Duke ju referuar të dhënave të mësipërme si dhe faktorëve të tillë si rritja e kërkesës për energji si rezultat i rritjes ekonomike të vendit, nga ana e OST sh.a është vlerësuar që rritja e kërkesës për energji të jetë në rendin 5% duke e çuar konsumin e pritshëm bruto për vitin 2017 në rendin 6,929 GWh, prej të cilave 6,135 GWh për OSHEE sh.a, 794 GWh për klient fundor që furnizohen në treg të parregulluar dhe 163 GWh energji humbje në rrjetin e transmetimit si dhe nevoja vetjake.

Duke iu referuar gradientit rritës prej 2% dhe duke përdorur profiling e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, OST sh.a. ka bërë parashikimin e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit për vitin 2018.

Mbulimi I kërkesës së pritshme, është bërë në bazë të eksperiencës shumë vjecare nga OST sh.a. duke marrë në konsideratë prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen potenciale të numrit dhe volumit të gjenerimit të PPE-ve, eksportin e mundshëm nga ana e tyre në varësi të kushteve të tregut të brendshëm të energjisë, importit të energjisë që behet nga ana e OSHEE dhe klient fundor që furnizohen në treg të parregulluar, duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit të tyre dhe kërkesën për energji, dhe duke treguar kujdes gjithashtu për optimizimin e kaskadës së Drinit, ruajtjen e kuotës në Fierzë, pra eficienten e gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjetër me një kuotë dhe rezerve energjetike optimale për të përballuar kërkesën për energji elektrike gjithmone në rritje.

OST sh.a ka vlerësuar që rritja e kërkesës për energji të jetë në rendin 5% duke e çuar konsumin e pritshëm bruto për vitin 2018 në rendin 7,231 GWh, prej të cilave 6,231 GWh për OSHEE sh.a, 1000 GWh për konsumatorët e kualifikuar dhe 169 GWh energji humbje në rrjetin e transmetimit si dhe nevoja vetjake.

Në kapitullin e katërt OST sh.a përshkruan funksionet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Tregut (OT). Për momentin, OT është pjesë e strukturës së OST sh.a në nivel Departamenti. Departamenti i Operatorit të Tregut administron rregjistrin e palëve të tregut si dhe ndjek procedurat përkatëse të rregjistrimit të tyre. *Kostot e OT janë përfshirë në koston e OST sh.a.*

Në kapitullin e pestë, kompania ka përshkruar në vija të përgjithshme zhvillimet në tregun e energjisë dhe modelin e tregut, në përputhje me Ligjin 43/2015 “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike”, që sollën ndryshime në strukturën organizative të OST sh.a.-se, struktura e cila, gjatë vitit 2017 u pasua me ndryshime në teresinë e saj si dhe krijimin edhe të Drejtorisë së Energjisë së Transmetuar, Humbjeve dhe Disbalancave.

Për vitin 2018, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 170 milionë kWh. OST sqaron se kjo sasi energjie do të blihet me baze tregu, dhe bazuar në të dhënat e HUPX është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 50 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 1,165 milion lekë.

Në lidhje me Prokurimin e kapacitetit rregullues dhe atij rezerve për shërbimin e balancimit, OST ka dhënë sqarime në lidhje me Rregullimin sekondar ku kërkon (1 milion Euro)134,4 milion lekë, Rregullimin tercial ku kërkon (4.4milion Euro)600 milion lekë si dhe ridispeçimin ku kërkon (3.6 milion Euro)493 milion lekë.

Në kapitullin e gjashtë ka paraqitur llogaritjen e tarifës së transmetimit për vitin 2018 ku përfshihen kostot kapitale dhe kostot operative.

Në kostot kapitale shoqëria ka planifikuar një sërë projektesh me fonde të huazuara të cilat janë në proces implementimi të tilla si:

- Ndërtimi I nenstacioneve të rinj 110/35/20 kV Orikum - Himarë
- Zgjerimin e nenstacionit 400 kV të Komanit
- Projektin për instalimin e matjes për konsumatorët TM dhe qendrës së menaxhimit të informacionit
- Projekti I eficiencës së energjisë që përshin ndërtimin e linjës 220 kV, Tirana 2 deri ne Rashbull si dhe fuqizimi I nenstacionit 220/110 kV Rashbull si dhe unaza 110 kV e Tiranës
- Ndërtimi I linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan 2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) si dhe zgjerimi I nenstacioneve Elbasan 2 dhe Fier
- Projekti për realizimin e një studimi masterplan për zhvillimin e sistemit të transmetimit, financuar nga nje grant I qeferisë Gjermane nëpërmjet Bankës KFV

Vlera e parashikuar me fondet e huaja për projektet e rendituara më sipër është e paraqitur në formë tabelare për sejcilin projekt në materialin e dërguar nga OST.

Për sa I përket investimeve për vitin 2018 me fondet e saj, OST ka parashikuar projektet si mëposhtë:

- Linja e re 220 kV Burrel Peshkopi dhe Nenstacioni 220/110/ kV Peshkopi
- Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400 kV 120 MVAr dhe traktit 400 kV ne nenstacionin Zemblak

Projektet te cilat priten të finalizohen gjate vitit 2018 me fondet e OST sh.a. paraqiten si mëposhtë:

- Ndertimi i linjes 110 kV N/st Sallmone – Gjiri i Lalezit
- Rikonstruksioni i linjes 110 kV dyfishe Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj –Ura e Matit
- Rikonstruksioni i impjantit 110 kV te nenstacionit Rubik
- Perfundimi i punimeve per venien ne pune te pjeses kabllore te linjes 110 kV Tirana 2-Selite
- Instalimi i infrastrukturave per kontroll - monitorimin e disa nenstacioneve te reja etj.

Llogaritja e Asetit Baze te Rregulluar (**RAB**) ne fillim te vitit baze 2018 (Vlera ne fund te vitit 2017) eshte kryer duke llogaritur kapitalizimin e te gjitha investimeve ne proces deri ne 31.12.2017. Ne llogaritjen e amortizimit te vitit 2018, eshte mbajtur parasysh fakti qe shtesat e vitit 2018 kontabilizohen pergjate gjithë vitit dhe jane amortizuar per mesatarisht 6 muaj duke marre ne konsiderate kohen ne te cilen kapitalizohen. Amortizimi i parashikuar për vitin pritet te jete rreth 2,180.6 milion leke ndersa Aseti Baze i Rregulluar (RAB) ne fillim te vitit 2018 eshte rreth 48,746.96 milion leke.

Angazhimi I OST sh.a. në kredi afatgjata, me qëllim financimin e projekteve madhore për zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, ka rritur detyrimet e shoqërisë për interes dhe principal për vitin 2018, të cilat arrijnë vlerën 4,077 milion lekë.

Shoqëria OST sh.a. në aplikimin e saj për vitin 2018 ka përshkruar (në mënyrë empirike) kostot operative për vitin 2018 të cilat janë paraqitur ne një tabelë përmbledhëse në këtë material.

Për vitin 2018 OST sh.a parashikon një rënie nga të ardhurat për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit në nivelin e 8 milionë Euro ose 1,096 milionë lekë nga rreth 10 milion eurove të cilat I ka realizuar gjatë vitit 2017.

Në kapitullin shtatë OST sh.a. ka paraqitur llogaritjen e pagesave për kapacitet dhe në formë tabelare shumë të kapacitetit total mujor të bazuar ne ngarkesen pik gjate periudhes 12 mujore per secilin klient te lidhur ne rrejtin e transmetimit (klient fundor që furnizohen në treg të parregulluar+ OSHEE).

Duke analizuar situaten elektroenergjitike per vitin 2018, OST sh.a. vlerëson se shuma e kapaciteteve totale te Konsumatoreve te Kualifikuar + OSHEE do te jete e barabarte me 1,450,000 kW.

Se fundi sic permendur ne fillim te relacionit paraqiten llogaritjet e tarifes ne kater versione te ndryshme si ne tabelen me poshte:

Metodologjia e llogaritjes se tarifave te transmetimit						
	Pershkrimi	Njesia	Viti 2018			
			Version 1	Version 2	Version 3	Version 4
	Niveli I synuar I te ardhurave (I+II+III)	Million Leke	Metodologjia	Mospagesa e huave	Mospagesa e huave, blerja e humbjeve ne treg	Mospagesa e huave, blerja e humbjeve dhe sherbimeve ndihmese me cmim te rregulluar
	$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}} - \text{Te ardhurat nga alokimi i kapaciteteve}$		11,015	6,939	5,845	4,681
I.	$C_{\text{kapital}} = R + D$		6,991	2,915	2,915	2,915
	1 Kthimi mbi kapitalin ($R = B * wacc$)	Million Leke	4,811	735	735	735
	a. B (Baza e rregulluar e asetëve)	""	48,747	48,747	48,747	48,747
	b. WACC = $[ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$	%	9.9%	1.5%	1.5%	1.5%
	ES - Objektiv per raportin e kapitalit te vet ne RAB	""	53.7%	53.7%	53.7%	53.7%
	T - Norma e takses se korporates	""	15%	15%	15%	15%
	ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	""	13.2%	2.4%	2.4%	2.4%
	DS - Objektiv per raportin e borxhit ne RAB	""	46.3%	46.3%	46.3%	46.3%
	CoD - Kosto e borxhit	""	3.4%	0.0%	0.0%	0.0%
	2 Amortizimi i vitit (D)	Million Leke	2,180	2,180	2,180	2,180
II.	C_{operuese}	""	5,124	5,124	4,031	2,866
	1 Personeli	""	1,326	1,326	1,326	1,326
	2 Sherbime administrative e te tjera	""	680	680	680	680
	3 Materiale te para	""	130	130	130	130
	4 Blerja e sherbimeve ndihmese	""	1,233	1,233	140	140
	5 Blerja e humbjeve	""	1,165	1,165	1,165	250
	6 Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	""	500	500	500	250
	7 Pagesë për organizmat rajonale e europiane	""	90	90	90	90
III.	$\text{Te ardhurat nga alokimi i kapaciteteve}$	""	(1,100)	(1,100)	(1,100)	(1,100)
	E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)	GWh	7,231	7,231	7,231	7,231
	Tarifa mesatare e transmetimit	Leke/kWh	1.52	0.96	0.81	0.65
1	$P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} / L$	Leke/kW/muaj	338.6	104.3	104.3	104.3
	$C_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} - \text{Te ardhurat nga Alokimi}$	Million leke	5,891	1,815	1,815	1,815
	L - shuma e kapacitetit total mujor	kW	1,450,000	1,450,000	1,450,000	1,450,000
2	$P_{\text{energjia}} = C_{\text{operuese}} / E$	Leke/kWh	0.71	0.71	0.56	0.40
	C operuese	Million leke	5,124	5,124	4,031	2,866
	E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)	GWh	7,231	7,231	7,231	7,231
3	$P_{\text{mesatare}} (\text{Tarifa mesatare e transmetimit}) = (C_{\text{kapaciteti}} + C_{\text{energjia}}) / E$	Leke/kWh	1.52	0.96	0.81	0.65

- **Versioni 1**

Ky version parashikon permbushjen e te gjitha detyrimeve te OST sh.a. pergjate vitit 2018, duke perfshire pagesen e detyrimeve per kredite te cilat aktualisht jane detyrim i OSHEE sh.a. per tu paguar referuar vendimeve të ERE nr. 52, datë 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016 të cilët përcaktojnë se:

“OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a dhe KESH sh.a.”;

Per vitin 2018 OST sh.a. duhet te paguaje rreth 4,077 milion leke ne baze te marreveshjeve per ripagimin e kredive me Ministrine e Financave dhe KESH sh.a. Vetem shtesa e detyrimit per te paguar kredite nga ana e OST sh.a. do te bente qe tarifa te rritej me 0.47 Leke/KWh = 4,077 milion leke / 7,231 GWh, me shume se tarifa aktuale prej 0.65 lekesh.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant arrin në **1,52 lekë/kWh**.

- **Versioni 2**

Sipas versionit 2 OST sh.a. vazhdon te mos paguaje kredite por ndryshimi ne krahasim me situaten aktuale eshte blerja ne treg te sherbimeve ndihmese me nje vlere prej rreth 1,233 milion lekesh ne vit nderkohe qe vlere me te cilen aktualisht po i siguron ato eshte 140 milion leke dhe blerja ne treg e energjise per mbulimin e humbjeve me nje vlere prej 1,165 milion lekesh nga rreth 250 milion leke aktualisht.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant arrin në **0,96 lekë/kWh**.

- **Versioni 3**

Ne versionin e 3-te, OST sh.a. siguron vetem blerjen e energjise per mbulimin e humbjeve ne treg nderkohe qe nuk paguan kredite dhe siguron sherbimet ndihmese me cmimin aktual nga KESH sh.a.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant arrin në **0,81 lekë/kWh**.

- **Versioni 4**

Versioni i 4-t eshte pothuajse i ngjashem me situaten aktuale te OST sh.a., pra energjia e nevojshme per te mbuluar humbjet ne transmetim dhe sherbimet ndihmese sigurohen nga KESH sh.a. me cmim te rregulluar si dhe kredite nuk paguhen referuar vendimeve të ERE nr. 52, datë 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant është tarifa aktuale prej **0,65 lekë/kWh**.

- **OPEX**

Në lidhje me kostot operative, në zërin shpenzime personeli, OST sh.a parashikon që gjatë vitit 2018 të ketë rritje të shpenzimeve për punonjësit sic paraqitet ne tabelen e mëposhtme:

	Emertimi	Viti 2016 fakt (mln Leke)	Realizimi i pritshem 2017 (mln Leke)	P/Programi i vitit 2018 (mln Leke)
-	Personel	967	1.253	1.326
-	Materiale të para	101	105	130
-	Furniturat dhe Shërbimet	443	400	650

Nga aplikimi vërejmë që Shoqëria kërkon 1,326 milionë lekë shpenzime personeli për vitin 2018, nga 1,253 milionë të realizuar për vitin 2017, pra, një rritje prej 5,8%.

Gjykojmë që rritja e shpenzimeve të personelit nga OST sh.a. është e paargumentuar, panvarësisht pyetjeve që I kemi drejtuar shoqërisë në lidhje me rritjen e këtij shpenzimi dhe për këtë arsye mendojmë që shpenzimet për personelin të miratohen në të njëjtin nivel të realizuar për vitin 2017 I cili përfaqëson dhe një rritje më të madhe se indeksi vjetor i rritjes së inflacionit.

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale që OST sh.a planifikon të shpenzojë për vitin 2018 arrijnë vlerën 130 milionë lekë. Megjithëse kjo shifër ka një rritje prej 23% krahasuar me shifrën faktike për vitin 2017, mendojmë që vlerat janë të tilla sa ndikimi i tyre është fare modest, ndaj, gjykojmë që kjo shifër të mos preket, pra, të miratohet 130 milionë lekë.

Për furnitura dhe shërbime, OST sh.a planifikon që për vitin 2018 të shpenzojë rreth 680 milionë lekë. Këtu hyjnë shpenzime nga të tretë si mirëmbajtje, siguracion, ujë, pagesa për ERE, etj. Meqënëse shoqëria nuk e ka paraqitur në aplikim dhe as në dokumentacionin plotësues në formë analitike këtë zë shpenzimi edhe pse kërkuar nga ana e jonë, nisur nga eksperiencia e deritanishme ku shoqëria në aplikimet e mëparshme ka parashikuar në këtë zë shpenzimi dhe gjoba ose dëmshpërblime u pa e arsyeshme reduktimi I këtij zëri me 80 milion lekë.

Gjithashtu, OST sh.a gjatë vitit 2018 parashikon të shpenzojë 1,165 milionë lekë për prokurimin e humbjeve në rrjet, humbje e cila është vlerësuar me rreth 169 milionë kWh. Nga Shoqëria OST sh.a parashikohet që kjo sasi energjie të blihet në treg dhe parashikohet të blihet me një çmim mesatar prej 50 Euro/MWh, bazuar në të dhënat e HUPX.

OST sh.a, në aplikimin e saj për tarifë parashikon që të shpenzojë rreth 500 milionë lekë për pagesa CBT-je për vitin 2018, shumë e cila varet nga marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Për llogaritjen e një shpenzimi të tillë OST sh.a është mbështetur edhe në trendin disavjeçar të këtyre lloj pagesave duke marrë në konsideratë dhe faktin se energjinë për mbulimin e humbjeve

që do të prokurojë në treg të parregulluar dhe se rritja e cmimit të prokurimit të humbjeve do të influencojë direkt në rritjen e pagesave për CBT. I qëndrojmë vlerësimin të shoqërisë bazuar në argumentimin e paraqitur nga OST sh.a.

Në aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018, OST sh.a ka parashikuar një sërë shpenzimesh që lidhen me prokurimin e kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit. Në total këto shpenzime, ku përfshihen kapacitetet rezervë të rregullimit dhe ridispeçerimi kapin shifrën prej 1,233 milionë lekësh, pa llogaritur këtu pagesat për anëtarësimin në organizmat rajonale e europiane në të cilat OST sh.a është angazhuar, të cilat llogariten në 90 milionë lekë.

Në lidhje me sa më sipër, vërejmë që shpenzimi faktik që OST sh.a ka realizuar për vitin 2015 është 117 milion lekë, ndërsa për vitin 2016 kap shifrën prej 94 milionë lekë, gjithashtu dhe për vitin 2017 arrin në 94 milion lekë. Nisur nga fakti se shërbimet ndihmëse mund të prokurohen në treg të parregulluar, gjykojmë të pranueshëm propozimin e OST sh.a në lidhje me këtë shpenzim në vlerën 1,233 milion lekë.

- **CAPEX**

Në këtë aplikim, OST sh.a ka përdorur si normë të lejueshme të kthimit mbi kapitalin normën prej 2,4% në mënyrë që të përballojë investimet e planifikuara në programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2017.

Për sa i përket strukturës së kapitalit të Shoqërisë, OST sh.a ka përdorur një strukturë me 46,3 % borxh dhe 53.7 % kapital të vetë e cila përfaqëson strukturën reale të kapitalit të shoqërisë. Kostoja mesatare e borxhit llogaritet nga OST sh.a në nivelin 3,4% .

I konsiderojmë të pranueshme normat e propozuara për kthimin mbi kapitalin dhe koston së borxhit.

- **RAB (Baza e Rregulluar e Aseteve)**

Më poshtë evidentohen lëvizjet e asetëve ndër vite:

Viti 2012

Nr.	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	2	3	4	5	6=3-5	
1	Software dhe licenca	205/208	3,415,650	775,620	775,620	2,640,030
2	Toka	211	2,191,833,298	2,327,478	2,327,478	2,189,505,820
3	Ndertesa	212	1,634,525,062	45,720,310	45,720,310	1,588,804,752
4	instalim, makinere dhe Paisje te tjera	213	31,026,649,845	1,373,603,649	1,373,603,649	29,653,046,196
5	Mjete transporti	215	242,137,153	31,133,394	31,133,394	211,003,759
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike, software dhe licenca	218	143,718,460	27,949,142	27,949,142	115,769,318
	Total		35,242,279,468	1,481,509,597	1,481,509,598	33,760,769,875

Viti 2013

Nr.	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	2	3	4	5	6=3-5	
1	Software dhe licenca	205/208	61,073,958	7,688,297	8,463,917	52,610,041
2	Toka	211	2,191,833,298	2,475,888	4,803,366	2,187,029,932
3	Ndertesa	212	1,650,645,538	45,908,119	93,867,782	1,556,777,756
4	instalim, makinere dhe Paisje te tjera	213	32,558,747,880	1,436,088,978	2,794,486,847	29,764,261,033
5	Mjete transporti	215	279,100,401	29,262,669	54,534,507	224,565,894
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike, software dhe licenca	218	114,667,593	28,471,510	64,706,793	49,960,800
	Total		36,856,068,668	1,549,895,461	3,020,863,212	33,835,205,456

Viti 2014

Nr.	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	2	3	4	5	6=3-5	
1	Software dhe licenca	205/208	71,175,654	13,222,703	21,686,621	49,489,033
2	Toka	211	2,297,083,739	5,866,055	10,669,421	2,286,414,318
3	Ndertesa	212	1,804,932,601	50,409,523	144,277,305	1,660,655,296
4	instalim, makinere dhe Paisje te tjera	213	33,294,858,252	1,468,543,372	4,263,030,219	29,031,828,033
5	Mjete transporti	215	605,296,823	35,728,267	90,262,774	515,034,049
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike, software dhe licenca	218	212,757,089	35,875,724	100,582,517	112,174,572
	Total		38,286,104,158	1,609,645,644	4,630,508,857	33,655,595,301

Viti 2015

Nr.	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
1	2	3	4	5	6=3-5	
1	Software dhe licenca	205/208	97,687,381	12,050,840	12,050,840	85,636,541
2	Toka	211	2,225,049,802	468,062	468,062	2,224,581,740
3	Ndertesa	212	1,752,169,735	44,959,252	44,959,252	1,707,210,483
4	instalim, makinere dhe Paisje te tjera	213	38,321,098,253	1,512,887,264	1,458,600,923	36,862,497,330
5	Mjete transporti	215	495,603,589	37,699,188	38,925,166	456,678,423
6	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike, software dhe licenca	218	182,436,581	21,510,240	21,499,650	160,936,931
	Total		43,074,045,341	1,629,574,846	1,576,503,893	41,497,541,448

Viti 2016						
Nr.	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	340,920,889	45,192,033	57,244,430	283,676,459
1	Toka	211	2,296,608,723	3,747,845	4,215,907	2,292,392,816
2	Ndertesa	212	2,585,321,719	62,948,435	107,685,683	2,477,636,036
3	instalim, makinere dhe Paisje te tjera	213	45,998,206,424	1,784,837,493	3,239,492,325	42,758,714,099
4	Mjete transporti	215	508,576,392	32,969,923	71,817,311	436,759,081
5	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike, software dhe licensa	218	714,081,496	93,647,540	115,123,163	598,958,333
	Total		52,443,715,646	2,023,343,273	3,595,578,824	48,848,136,824
Viti 2017						
Nr.	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	416,494,806	75,833,427	120,769,774	295,725,032
1	Toka	211	2,296,608,723	429,056	1,365,180	2,295,243,543
2	Ndertesa	212	2,625,196,436	69,109,839	177,581,381	2,447,615,055
3	instalim, makinere dhe Paisje te tjera	213	47,186,002,053	1,943,357,631	5,128,027,410	42,057,974,643
4	Mjete transporti	215	556,428,792	35,949,184	104,194,850	452,233,942
5	Mobileri, pajisje zyre, pajisje informatike, software dhe licensa	218	1,037,847,827	174,464,280	292,863,499	744,984,328
	Total		54,118,578,640	2,299,143,421	5,824,802,099	48,293,776,543

Ne lidhje me vleren e asetëve te konsideruar ne llogaritjen e RAB-it dhe saktesimin e tij per vitet 2015, 2016 bazuar ne te dhenat e pasqyrave financiare te ketyre viteve rezultojne vlerat e pasqyruara ne tabelen llogaritese te tarifes se transmetimit ne vijim:

Zerat	Njesia	Miraturar nga ERE 2015	Realizimi 2015 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi 2016 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi sipas te dhenave te derguara me shkresen 758/4 per vitin 2017 dhe biznes planit te OST sh.a	Aplikimi I OST per vitin 2018	ERE 2018
Vlera e aseteteve 2010	000/leke	13,954	13,954	13,954			13,954
Vlera e investimeve te bera 2010		1,861	1,861	1,861			1,861
Vlera e investimeve te parashikuara 2011 (1/2)		9,957	9,957	9,957			9,957
Vlera e investimeve te parashikuara 2012 (1/2)		4,343	4,343	4,343			4,343
Vlera e investimeve te parashikuara 2013 (1/2)		1,656	1,656	1,656			1,656
Vlera e investimeve te parashikuara 2014 (1/2)		4,482	4,482	4,482			4,482
Vlera e investimeve te parashikuara 2015 (1/2)		4,562	7,650	8,746			8,746
Vlera e investimeve te parashikuara 2016 (1/2)				3,109	52,443		3,109
Vlera e investimeve te parashikuara 2017 (1/2)					1,674		2,183
Vlera e investimeve te parashikuara 2018 (1/2)							1,085
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2011							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2012							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2013							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2014		(8,660)					
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2015			(10,290)				
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2016				(12,314)	(14,613)		
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2017							(17,034)
Amortizimi i pritshem 2012							
Amortizimi i pritshem 2013							
Amortizimi i pritshem 2014		(1,625)					
Amortizimi i pritshem 2015			(1,630)				
Amortizimi i pritshem 2016							
Amortizimi i pritshem 2017	"			(2,024)			
Amortizimi i pritshem 2018					(2,299)		(2,421)
Minus Grantet		(435)	(620)	(594)	(718)		
Vlera neto e Aseteve	000/leke	30,095	31,363	33,176	36,487	48,747	31,921

Sic verehet nga tabela, Vlera Neto e aseteteve pasi janë marrë në konsideratë të dhënat faktike të bilancit 2015 arrin në 31,363 milion lekë, 2016 arrin në 33,176 milion lekë, realizimi I pritsëm për vitin 2017 sipas raportimeve të fundit me 36,487 milion lekë. Për vitin 2018 OST deklaron se vlera Neto e aseteteve do të jetë 47,747 milion lekë. Nga llogaritjet tona nisur nga Kosto historike Vlera Neto e aseteteve të parashikuara pas analizës së pasqyrave financiare të dërguara na OST sh.a rezulton në 31,921 milion lekë.

- **Amortizimi**

Fillimisht Amortizimi I paraqitur nga OST sh.a. në aplikimin për tarifë është në vlerën 2,180 milion lekë dhe në shkresën 758/4 është rillogaritur me 2,421, vlerë kjo e cila është marrë në konsideratë në llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) nga grupi I punës sic vërehet dhe në tabelën e mësipërme.

- **Investimet**

OST sh.a nuk ka paraqitur në ERE plan të investimeve si parashikohet në neni 60 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, por pavarësisht kësaj është përfshirë në llogaritjet tona gjysma e investimeve të parashikuara për vitin 2018 meqenëse këto investime shërbejnë në

garantimin dhe përshtatshmërinë e sistemit të transmetimit dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Në lidhje me investimet që kompania pret të realizojë përgjatë vitit 2018 na është vënë në dispozicion tabela si më poshtë, të cilat kompania pret ti realizojë me fondet e veta:

Nr.	Objekti Investime	Fondi i perafert (Leke)
1	Linja e re 220 kV Burrel – Peshkopi dhe N/st 220/110 kV Peshkopi	500.000.000
2	Furnizim vendosje e shunt reaktorit 400kV 120 MVar dhe traktit 400 kV ne N/st Zemblak	500.000.000
3	Ndertimi i linjes 110 kV N/st Sallmone – Gjiri i Lalezit	195.000.000
4	Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit	195.000.000
5	Rikonstruksioni i anes 110 kV te nenstacionit Rubik	130.000.000
6	Perfundimi i punimeve per venien ne pune te pjeses kablore te linjes 110 kV Tirana 2-Sellte	65.000.000
7	Instalimi i infrastrukturave per Kontroll - Monitorimin e disa nenstacioneve te reja	65.000.000
8	Instalimi i OPGW ne linjen 220 kV Burrel – Elbasan 1	52.000.000
9	Instalimi i OPGW ne linjen e interkonjeksionit Shqiperi - Greqi	50.000.000
10	Blerja e platformes per transparencen REMIT	50.000.000
11	Blerje makinash per repartet e linjave te NJO dhe NJMT	40.000.000
12	Implementimi i Sistemit te Analizimit te Rrjetit nepermjet PMU (Phasor Measuring Unit)	40.000.000
13	Licensa te Produkteve Microsoft	37.377.428
14	Ndertimi i Magazines prane N/stacionit Tirana2	35.000.000
15	Upgrade i sistemit te kontrollit te nenstacionit 400 kV Elbasan 2.	35.000.000
16	Furnizim vendosje e traktit te linjes 110-13 ne N/stacionin Lac1	35.000.000
17	Upgrade i sistemit te kontrollit te nenstacionit 220 kV Koplik.	30.000.000
18	Blerje pajisjesh kompjuterike per administraten qendrore dhe njesiste operative	30.000.000
19	Blerje Automjete për administraten e OST sh.a	20.000.000
20	Blerje pajisjesh kompjuterike per zevendesimin e pjeses Hardware te Sistemit SCADA/EMS dhe sistemeve te Kontroll-Monitorimit	15.000.000
21	Sistem akses kontrolli per hyrje daljet e personelit sebashku me nje Software per perlogaritjen automatike te oreve te punes si dhe integrimin me sistemin pagave.	15.000.000
22	Blerje program kompjuterik per krijimin, mirembajtjen, analizen, konvertimin dhe shkembimin e modeleve te rrjetave te transmetimit ne formatet qe perdoren nga PSSE(.raw, .sav, .seq, .dyr) dhe formatin e kerkuar nga ENTSO-E: CIM Profile, CGMES.	14.000.000
23	Plotesimi dhe venia ne pune e Traktit 110 kV ne nestacion Fier per N/stacionin 110/20 kV te OSHEE	10.000.000
24	Tonera dhe aksesore per pajisje printimi multifunksionale	7.000.000
25	Blerje pajisjesh reserve per mirembajtjen e sistemeve lokale te Kontroll-Monitorimit.	5.000.000
TOTALI		2.170.377.428

Effekti i këtyre investimeve është reflektuar në tabelën e llogaritjes së RAB të paraqitur më lartë.

• **Tarifa E Transmetimit për Vitin 2018**

Më poshtë evidentohet tabela e parashikimit të tarifës së transmetimit për vitin 2018.

Zerat	Njesia	Miratuar nga ERE 2015	Realizimi 2015 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi 2016 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi sipas te dhenave te derguara me shkresen 758/4 per vitin 2017 dhe biznes planit te OST sh.a	Aplikimi I OST per vitin 2018	ERE 2018
Mirembajtje	000/leke	150	203	103	105	130	130
Personeli	"	1,045	1,020	1,013	1,253	1,326	1,253
Blerje energji per humbjet	"	266	231	320	236	1,165	1,165
Sherbime ndihmese			117	94	94	1,233	1,233
CBT		350	188	170	250	500	500
Furnitura dhe Sherbime		470	417	396	335	680	600
Pagese per organizmat rajonale europian				19	64	90	90
Totali OPEX	000/leke	2,281	2,176	2,115	2,336	5,124	4,971
Vlera e aseteteve 2010	000/leke	13,954	13,954	13,954			13,954
Vlera e investimeve te bera 2010		1,861	1,861	1,861			1,861
Vlera e investimeve te parashikuara 2011 (1/2)		9,957	9,957	9,957			9,957
Vlera e investimeve te parashikuara 2012 (1/2)		4,343	4,343	4,343			4,343
Vlera e investimeve te parashikuara 2013 (1/2)		1,656	1,656	1,656			1,656
Vlera e investimeve te parashikuara 2014 (1/2)		4,482	4,482	4,482			4,482
Vlera e investimeve te parashikuara 2015 (1/2)		4,562	7,650	8,746			8,746
Vlera e investimeve te parashikuara 2016 (1/2)				3,109	52,443		3,109
Vlera e investimeve te parashikuara 2017 (1/2)					1,674		2,183
Vlera e investimeve te parashikuara 2018 (1/2)							1,085
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2011							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2012							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2013							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2014		(8,660)					
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2015			(10,290)				
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2016				(12,314)	(14,613)		
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2017							(17,034)
Amortizimi i pritshem 2012							
Amortizimi i pritshem 2013							
Amortizimi i pritshem 2014		(1,625)					
Amortizimi i pritshem 2015			(1,630)				
Amortizimi i pritshem 2016							
Amortizimi i pritshem 2017	"			(2,024)			
Amortizimi i pritshem 2018					(2,299)		(2,421)
Minus Grantet		(435)	(620)	(594)	(718)		
Vlera neto e Aseteve	000/leke	30,095	31,363	33,176	36,487	48,747	31,921
Kapitali i punes	000/leke	190.08	181.31	176.28	194.69	427.00	414.25
Baza e Rregulluar e Aseteve	"	30,285	31,544	33,353	36,682	49,174	32,335
AROE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	(%)	3.46%	3.46%	3.46%	6.00%	2.40%	2.40%
ES - Objektiv per raportin e kapitalit te vet ne RAB	"	40.00%	45.97%	46.33%	47.70%	53.70%	53.70%
T - Norma e takse se korporates						15.00%	15.00%
CoD - Kosto e borxhit	"	3.46%	3.46%	3.46%	1.50%	0.00%	3.40%
DS - Objektiv per raportin e borxhit ne RAB	"	60.00%	54.02%	53.66%	52.30%	46.30%	46.30%
WACC (Weighted Average Cost of Capital)	(%)	3.61%	3.46%	3.46%	3.647%	1.5%	3.09%
Kthimi I lejuar mbi (RAB)	000/leke	1,094	1,091	1,154	1,337.60	745.59	999.30
Kompensim alokimi I kapaciteteve		(900)	(1,703)	(1,489)	(1,500)	(1,100)	(1,100)
Kompensim I te ardhurave te kerkuara	000/leke			(165)			
Amortizimi I vitit		1,625	1,629	2,024	2,299	2,180	2,421
Axhustim I periudhes se meparshme							
<i>Axhustim 2015</i>							(1,172)
<i>Axhustim 2016</i>							(637)
<i>Axhustim 2017</i>							(31)
Total I Te Ardhurave te Kerkuara	000/leke	4,100	3,193	3,640	4,473	6,950	5,451
Energjia Neto e Transmetuar	MWh	6,288	6,716	6,580	6,929	7,231	7,231
Tarifa mesatare e transmetimit	Leke/kWh	0.65	0.48	0.55	0.65	0.96	0.75
			(0.17)	(0.10)	(0.00)		
Diference ne te ardhurat ne tarifen e realizuar krahasuar me tarifen e miratuar			(1,172)	(637)	(31)		

Në aplikim theksohet se volumi i transaksioneve të energjisë dhe si rrjedhojë edhe i kërkesës për kapacitete transmetuese në interkonjeksion, nuk është proporcional përgjatë gjithë muajve të vitit dhe se merren parasysh risite dhe paqartësitë e alokimit të kapaciteteve në interkonjeksione nga zyra përkatëse rajonale, SEECAO në Podgoricë në parashikimin e të ardhurave që OST mund të sigurojë në ankandet e alokimit të kapacitetit në interkonjeksion përgjatë gjithë vitit 2018 të cilat parashikon të jenë rreth 8 milion Euro ose 1,100 milion lekë dhe që do të sigurohen nga Pjesmarrësit e Tregut.

Nga të dhënat faktike të pasqyrave financiare të viteve 2015, 2016 dhe atyre të pritshme për vitin 2017 rezulton se tarifat faktike respektive të transmetimit për këto vite janë 0,48 leke/kWh, 0,55 leke/kWh dhe 0,65 leke/kWh. Bazuar në këto nivele tarifash është llogaritur efekti në të ardhurat e shoqërisë duke u reflektuar si axhustim i periudhave të kaluara në llogaritjen e tarifës për vitin 2018 në zbritje për vlerat 1,172 milion lekë, 637 milion lekë dhe 31 milion lekë si të ardhura të tepërta përkatisisht për vitet 2015, 2016 dhe 2017 kundrejt tarifës së miratuar prej 0,65 leke/kWh për këto vite.

Nga sa shpjeguar dhe evidentuar në tabelë si mësipër rezultantja e të gjithë komponenteve të të ardhurave të kërkuara për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 llogaritet në një vlerë totale prej 5,391 milion lekë dhe tarifa mesatare e transmetimit e llogaritur për sasinë (7,231 GWh) që parashikohet të lëvrohet në rrjetin e transmetimit rezulton 0.75 lekë/kWh.

Duke konsideruar faktin që procedura për shqyrtimin e aplikimit dhe analiza e informacionit shtese dhe sqarimeve perkatese sipas konstatimeve te mesiperme, kerkon kohen e saj, nderkohe qe aplikimi nga ana e OST sh.a.eshte tejet i vonuar, në lidhje me OPEX dhe CAPEX në tërësi, rezervojmë të drejtën e rishikimit të këtyre shpenzimeve në periudhat e ardhshme kundrejt vlerave reale të tyre.

Bazuar në nenet 16, 19 gërma “c/i” të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Nenit 19 pika 1 gërma “c” dhe nenit 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedruave të ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17,06,2016, nisur dhe nga arsyetimet dhe analizën e mësipërme, rezultatin e llogaritjeve përkatëse mbi tarifën mesatare të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, i propozojmë Bordit të ERE-s:

- **Miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018 prej 0,75 lekë/kWh.**